Vendim nr. 333, datë 20.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 20.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DEDË NIKA,** përfaqësuar nga avokati Mirash Martini, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2727 (30-2024-9192), datë 10.12.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-299, datë 12.03.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 29, 34, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Rezulton se në datën 04.01.2020, rreth orës 22:00, salla operative e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër ka njoftuar se në banesën e punonjësit të policisë, shtetasit P.M., kishte ndodhur një shpërthim me lëndë plasëse të llojit "eksploziv". Pas kryerjes së veprimeve procedurale për këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*Prokuroria e Shkodrës*) ka regjistruar procedimin penal nr. 3 të vitit 2020 për kryerjen e veprave penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", "Kanosja për shkak të detyrës" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 152, paragrafi i parë, 238, paragrafi i tretë dhe 278, paragrafi i parë, të Kodit Penal (*KP*).

2. Po ashtu, rezulton se në datat 21.10.2019 dhe 06.11.2019, në zonën e Dukagjinit janë vrarë me armë zjarri shtetasit L.A. dhe Gj.K. Lidhur me këto ngjarje në Prokurorinë e Shkodrës janë regjistruar procedimet penale përkatëse për kryerjen e veprave penale "Vrasja me paramendim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 78 dhe 278 të KP-së. Në kuadër të hetimeve për këto dy ngjarje, Prokuroria e Shkodrës i ka kërkuar gjykatës lejimin e përgjimit të bisedave e komunikimeve telefonike për disa numra telefoni celular, me qëllim zbulimin e autorit/autorëve të vrasjeve. Në kuadër të këtyre përgjimeve, ka rezultuar se dy ndër numrat e telefonit, për të cilët ishte lejuar përgjimi, kanë qenë njëri në përdorim të kërkuesit dhe tjetri në përdorim të shtetasit A.A.

3. Referuar këtyre përgjimeve telefonike, rezulton se në datën 06.01.2020 është zhvilluar një bisedë ndërmjet kërkuesit dhe shtetasit A.A., ku deklaronin se punonjësin e policisë, shtetasin P.M., e kishin paralajmëruar edhe më parë dhe se i kishin vënë eksploziv. Po në kuadër të përgjimeve për procedimin lidhur me vrasjen e shtetasit L.A., nga transkriptimi i këtyre bisedave telefonike kanë rezultuar disa biseda në interes të hetimit të ngjarjes kur i është vënë lënda plasëse derës së oborrit të punonjësit të policisë P.M. Referuar rezultateve të transkriptimit të bisedave telefonike, rezulton se në datën 04.01.2020, ora 12:57:23, është zhvilluar kjo bisedë mes kërkuesit dhe një shtetasi tjetër, si vijon: Kërkuesi: "*A ke pa gjurmë a gja?"* Shtetasi tjetër: "*Po do qarkullime i kam pa".* Po ashtu, në datën 05.01.2020, në orën 6:59:55 (pm), kërkuesi ka dërguar në numrin e telefonit celular që rezultonte në përdorim nga shtetasi A.A. një mesazh me këtë përmbajtje: "*Mrm ca bane shihi lajmet te star plusi në 8*". Në datën 05.01.2020, në orën 09:06:16 (pm), kërkuesi, ka dërguar në numrin e telefonit celular në përdorim të shtetasit A.A. një mesazh me këtë përmbajtje: "*Aipave ef*".

4. Po ashtu, rezulton se në datën 06.01.2020, në orën 11:26, ndërmjet kërkuesit dhe shtetasit A.A. është zhvilluar biseda me përmbajtje si vijon: - A.A.: *Qitash (Itesh) më ka ardhë*

mesazhi që më pate cu mramë [...]. Kërkuesi: *Ca thu* – A.A.: *Rapt po[...]. Ca kje* - Kërkuesi: *aaa, shife prap se nuk do të ket ik hala[...].* A.A.: *Po për ca bahet fjal?* Kërkuesi: *Paj, për një dashamir[...].* – A.A.: *aaa?* Kërkuesi: *Po, nji paralajmërim ja kem pa dhanë eee[...].* - A.A.: *Ça je ka thu ej*? - Kërkuesi: *Po mana po...* – A.A.: *Jo, nuk i kena pa, se nuk kena as drita tesh. Tash boll marak po më mesin!* - Kërkuesi: *aaaa?* – A.A.: *Po.* - Kërkuesi: *Aaaa! Unë kure pava në internet ka 7 sahati, pava lajmet te Top Cenelli e nuk e dha gja, kuri shof te Shkodra, i dha...* – A.A.: *aaaa?!* - Kërkuesi: *Po*. A.A.: *Po për ça u bake fjalë, a dihet gja?* - Kërkuesi: *A don me të kallxue shqip?* - A.A: *Po robt e shpisë*. - Kërkuesi: *I kem pa vu nji asisojet atij Prel Milanit*. – A.A.: *Ehë...* - Kërkuesi: *Ja kem pa vu larg e s'ssssss'ka badamtim t'madh!* – A.A.: *Aaa?* - Kërkuesi: *Krejt pak...* – A.A.: *Mos dert*. Kërkuesi: *Po për zotën po! e dha televizori, e kan vu tha si punë paralajmërimi për shkak detyrës... pa për zotën pa.* – A.A.: *A u gjet taroçi dje?* - Kërkuesi: *Ja...*

5. Lidhur me rezultatet e përgjimeve telefonike, Prokuroria e Shkodrës ka marrë vendim për marrjen e akteve nga procedimi penal lidhur me vrasjen e shtetasit L.A. dhe konkretisht pjesë të transkriptit të procesverbalit të datës 06.01.2020, pasi është vlerësuar e domosdoshme për sqarimin e rrethanave të procedimit penal nr. 3 të vitit 2020. Pasi ka analizuar rezultatet e përgjimeve, Prokuroria e Shkodrës ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme se kërkuesi mund të jetë një nga personat që ka vendosur lëndën plasëse në banesën e punonjësit të policisë P.M. dhe për këtë arsye i është drejtuar gjykatës me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg" ndaj tij, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit". Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 30 (253), datë 23.01.2023.

6. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Shkodrës ka kërkuar deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", të kryer në bashkëpunim, "Kanosja për shkak të detyrës", të kryer në bashkëpunim" dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 152, paragrafi i parë e 25, 238, paragrafi i tretë e 25 dhe 278, paragrafi i parë e 25, të KP-së.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 1100, datë 21.06.2024, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat është akuzuar, duke caktuar edhe dënimet përkatëse për to, dhe bazuar në nenin 55, paragrafi i parë, të KP-së, në bashkim të dënimeve, dënimin e tij me një dënim të vetëm prej 5 (pesë) vjetësh e 6 (gjashtë) muajsh burgim. Sipas gjykatës së shkallës së parë, në analizë të provave të shqyrtuara, krijohet

bindja përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi në bashkëpunim me persona të tjerë ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, dhe këto vepra penale janë kryer për shkak të detyrës që kryente punonjësi i policisë, shtetasi P.M., pasi ai ka marrë pjesë në aksionet e policisë për asgjësimin e bimëve narkotike që ishin mbjellë në zonën e Dukagjinit. Po sipas asaj gjykate, veprimet e kërkuesit kanë pasur si qëllim kanosjen e punonjësit të policisë. Këtë vendimmarrje të saj gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në rezultatet e procesverbaleve të vendit të ngjarjes, tabelës fotografike të vendit të ngjarjes, rezultatet e procesverbaleve të transkriptimit të bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet kërkuesit dhe një personi tjetër, deklarimeve të dhëna para gjykatës nga punonjësi i policisë dhe bashkëshortja e tij, si dhe mekanizmit të ngjarjes. Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim kërkuesi.

8. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2727 (30-2024-9192), ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1100, datë 21.06.2024 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas gjykatës së apelit, në rastin konkret provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që kërkuesi ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova, ndërsa pretendimet e kërkuesit për pafajësinë e tij dhe se akuzat nuk janë provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, janë të pabazuara. Në vlerësimin e gjykatës së apelit, pohimi i rrethanave të faktit penal, i bërë në mënyrë spontane nga kërkuesi përgjatë një bisede telefonike, përbën provë të plotë dhe të drejtpërdrejtë të përgjegjësisë, pa pasur nevojë të konfirmohet nga elemente të tjera provuese, pasi biseda e tij me shtetasin A.A. në datën 06.01.2020 nuk është një bisedë me kode, e paqartë ose e paplotë, por ajo përmban një rrëfim të plotë dhe spontan të faktit penal, duke e kualifikuar si provë të drejtpërdrejtë.

9. Po sipas gjykatës së apelit, nga përgjimet telefonike, veçanërisht komunikimet me shtetasin A.A., ku i pandehuri deklaron, ndër të tjera: "*Po nji paralajmërim jan kem pa dhanë eee…*", tregon një pohim të drejtpërdrejtë dhe të qartë të motivit të veprës penale, që përputhet me akuzën e kanosjes për shkak të detyrës. Sipas asaj gjykate, fraza "*i kem pas vu nji asisojet atij Prel Milanit*" është rrëfimi i pastër i veprimit, vendosjes së lëndës plasëse, ndërkohë që duke u shprehur se "*Ja kem pa vu larg e s'ka ba damtim t'madh*", jep të dhëna specifike, çka tregon edhe njohuritë e tij të hollësishme, të atilla që mund të jepen vetëm prej autorit. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se nga transkriptimi i bisedave telefonike të përgjuara, të vlerësuara në harmoni me provat e tjera, sipas parashikimeve të nenit 152, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), rezulton se ato janë komunikime spontane, me një bashkëbisedues të besuar dhe fjalët e përdorura janë të qarta dhe nuk lënë hapësirë për interpretim të kundërt, pasi janë komunikime lehtësisht të kuptueshme dhe shprehjet e

përdorura janë drejtpërdrejt tregues të veprave penale. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-299, datë 12.03.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke analizuar provat e marra e të verifikuara në proces, në përputhje me nenin 152 të KPP-së dhe duke arsyetuar mjaftueshëm se përgjegjësia penale e të gjykuarit është provuar tej çdo dyshimi të bazuar në prova. Po sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim dhe analizë pretendimet e kërkuesit dhe ndryshe nga sa pretendon ky i fundit, vendimi i asaj gjykate (apelit) nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

11. Në datën 15.07.2026 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 23.07.2026.

12. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

13.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* pasi edhe pse nga kërkuesi gjatë gjykimit në gjykatën e apelit është kërkuar një ekspert gjuhëtar që të bënte transkriptimin e bisedave telefonike të tij, si prova e vetme mbi bazën e së cilës ai është dënuar, kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata e apelit. Në dosjen gjyqësore janë dy procesverbale transkriptimi për këtë bisedë të zhvilluar nga kërkuesi me shtetasin A.A. në datën 06.01.2020. Në procesverbalin e datës 10.01.2020 është shkruar sikur kërkuesi thotë: "*Kam vu një asisoj, atij Prel Milanit*", ndërsa në procesverbalin e datës 01.03.2020 është shënuar sikur ka thënë: "*Kem vu një asisoj, atij Prel Milanit*". Asnjë nga këto transkriptime nuk është i saktë dhe për këtë arsye ishte e nevojshme marrja e mendimit të një eksperti gjuhëtar. Refuzimi i marrjes së kësaj prove themelore, e cila ka qenë e vetme dhe vendimtare për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesit, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo shkelje nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret paraprake të legjitimimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

16. Lidhur me kriterin e legjitimimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuesit lidhet me vlerësimin e provave të bëra nga gjykatat e zakonshme, duke e paraqitur në këndvështrim të cenimit të *parimit të prezumimit të pafajësisë*. Në thelb ai pretendon se duke qenë se është dënuar vetëm mbi bazën e transkriptimit të një bisede telefonike të zhvilluar ndërmjet tij dhe shtetasit A.A., gjykata e apelit nuk e ka pranuar kërkesën e tij për thirrjen e një eksperti gjuhësor për të bërë transkriptimin e asaj bisede, për të sqaruar se çfarë kuptimi ka shprehja "*Kam vu një asisoj, atij Prel Milanit*" ose shprehja tjetër "*Kem vu një asisoj, atij Prel Milanit*". Sipas kërkuesit, asnjë nga këto shprehje të transkriptuara në procesverbalet e vlerësuara nga gjykatat nuk është e saktë dhe për këtë arsye ishte e nevojshme marrja e mendimit të një eksperti gjuhëtar. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se kjo shkelje nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë.

17. Parimi i prezumimit të pafajësisë sanksionohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të paraqitura nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime *(shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka cenuar parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë çështja i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se kur mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme është vënë në dyshim nga kërkuesi, si shkak për të cilin atij i është cenuar e drejta themelore për t'u prezumuar i pafajshëm, vlerësimi i provave është pjesë e juridiksionit kushtetues (*shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë rast, Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa më lart, në vijim, bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Kolegji do të analizojë vlerësimin e provave në procesin penal të zhvilluar ndaj

kërkuesit, në kuptimin e garancive të parimit të prezumimit të pafajësisë, pra nëse ka pasur zhvendosje të barrës së provës nga prokurori te kërkuesi dhe nëse fajësia e këtij të fundit është vendosur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

20. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykatat e faktit, pasi kanë shqyrtuar provat e administruara në gjykim, në vendimet e tyre kanë parashtruar mënyrën e vlerësimit të provave dhe arsyet mbi të cilat kanë mbështetur përfundimet për fajësinë e kërkuesit. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkuesi në bashkëpunim me persona të tjerë kanë mbajtur pa lejen e organeve kompetente shtetërore lëndë plasëse të llojit "tritol", të cilën e kanë vendosur në afërsi të murit rrethues të banesës së punonjësit të policisë. Në këtë përfundim ajo është mbështetur, ndër të tjera, në rezultatet e procesverbaleve të vendit të ngjarjes, tabelës fotografike të vendit të ngjarjes, rezultateve të procesverbaleve të transkriptimit të bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet kërkuesit dhe një personi tjetër, deklarimeve të dhëna para gjykatës nga punonjësi i policisë dhe bashkëshortja e tij, si dhe mekanizmit të ngjarjes (*shih paragrafin 7 të vendimit*).

21. Ky arsyetim është gjetur i drejtë nga gjykata e apelit, e cila i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për pafajësinë e tij, për faktin se nuk ishte vërtetuar akuza tej çdo dyshimi të arsyeshëm, për pamjaftueshmërinë e provave dhe se vendimi ishte bazuar në një provë të vetme. Sipas asaj gjykate, nga provat e administruara rezulton se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, pasi në bashkëpunim me persona të tjerë ka vendosur lëndë plasëse të llojit "tritol" në oborrin e banesës të punonjësit të policisë, duke dëmtuar derën e pasme të oborrit dhe ky veprim është kryer për shkak të detyrës që ushtronte viktima, i cili kishte marrë pjesë në aksionin për asgjësimin e lëndës narkotike që ishte mbjellë në zonën e Dukagjinit. Për sa i përket anës subjektive, gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkuesi ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ka parashikuar karakterin shoqërisht të rrezikshëm të veprimeve të tij dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme e të vullnetshme, duke mbajtur në mjedis lëndë plasëse, por edhe duke e përdorur atë. Po ashtu, gjykata e apelit në vendimmarrjen e saj ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi të gjithë transkriptimin e bisedës telefonike të zhvilluar ndërmjet kërkuesit dhe shtetasit A.A. (*shih paragrafët 8-9 të këtij vendimi dhe 64, 68 dhe 69 të vendimit të gjykatës së apelit*)

22. Vendimi i gjykatës së apelit është vlerësuar i drejtë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit ajo gjykatë (gjykata e apelit) e ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke analizuar provat e marra e të verifikuara në proces në përputhje me nenin 152 të KPP-së dhe duke arsyetuar mjaftueshëm se përgjegjësia penale e të gjykuarit është provuar tej çdo dyshimi

të bazuar në prova, si dhe duke i marrë në shqyrtim dhe analizë pretendimet e kërkuesit, dhe duke i dhënë atij përgjigje të arsyetuar për to (*shih paragrafin 10 të vendimit*).

23. Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se gjykata e apelit nuk e ka bazuar vendimmarrjen e saj për fajësinë e kërkuesit vetëm në atë pjesë të bisedës që kërkuesi pretendon se duhej të thirrej eksperti gjuhësor, pasi vlerësimi i asaj gjykate është bazuar në të gjitha transkriptimet e bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet kërkuesit dhe shtetasit A.A. Po kështu, nuk rezulton që gjykata e apelit t'i ketë kërkuar kërkuesit të provojë pafajësinë e tij, por ajo ka vlerësuar provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe i ka ballafaquar ato me versionin e tij. Fakti se ky version nuk është pranuar nga kërkuesi nuk nënkupton, në vetvete, zhvendosjen e barrës së provës ose paragjykimin e fajësisë së tij. Në këto rrethana, nuk evidentohet që përfundimet e gjykatës së apelit të jenë mbështetur në aludime ose dyshime, ose që mënyra e vlerësimit të provave prej saj të jetë haptazi arbitrare ose e paarsyeshme në kuptimin kushtetues. Po kështu, nuk konstatohet që përfundimi i gjykatës së apelit për dashjen e kërkuesit të jetë mbështetur në një prezumim fakti të paarsyeshëm, pasi ai është nxjerrë nga një tërësi rrethanash konkrete të ngjarjes dhe nga tërësia e transkriptimit të bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet tij dhe një shtetasi tjetër. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se përdorimi i prezumimeve të faktit nuk është, në vetvete, i papajtueshëm me parimin e prezumimit të pafajësisë, për sa kohë ato mbahen brenda kufijve të arsyeshëm, duke pasur parasysh rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe duke respektuar të drejtat e mbrojtjes *(shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Për sa i përket gjykimit të zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton të jetë cenuar e drejta e kërkuesit për proces të rregullt ligjor. Edhe pse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetim të kufizuar, ky arsyetim është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për vendimmarrjet e marra në dhomën e këshillimit, pasi u jep përgjigje pretendimeve që hynin në juridiksionin e saj dhe bën të mundur kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit, i lexuar së bashku me paraqitjen e shkaqeve të rekursit dhe arsyetimin e gjykatave të faktit, bën të identifikueshme arsyet e mospranimit. Në këto rrethana, fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk përbën, në vetvete, një element që vë në dyshim drejtësinë e procedurës së ndjekur ose pajtueshmërinë e saj me garancitë kushtetuese të procesit të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.